



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2021:057102

Datë: 22.01.2024

Numri i dokumentit: 05220886

C.nr.1161/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Përparim Zeka, në çështjen juridike kontestimore të paditësve A.M.Sh., M.R., V.R., D.H. dhe B.K., kundër të paditurës Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensim i pagave jubilarë, jashtë seancës, me datë 19.01.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësve A.M.Sh., M.R., V.R., D.H. dhe B.K. dhe DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit në Prishtinë, që paditësve t'ia paguaj shumat si në vijim:

-Paditëses së parë: A.M.Sh. në emër të shpërblimit jubilar për 12 vite përvojë pune t'ia paguaj 50 % të vlerës së një page bazë dhe atë në shumën prej 210.62€.

-Paditëses së dytë: M.R. në emër të shpërblimit jubilar për 11 vite përvojë pune t'ia paguaj 50 % të vlerës së një page bazë dhe atë në shumën prej 223.97€.

-Paditëses së tretë: V.R. në emër të shpërblimit jubilar për 13 vite përvojë pune t'ia paguaj 50 % të vlerës së një page bazë dhe atë në shumën prej 225.76€.

-Paditëses së katërt: D.H. në emër të shpërblimit jubilar për 18 vite përvojë pune t'ia paguaj 50 % të vlerës së një page bazë dhe atë në shumën prej 230.24€.

-Paditësit të pestë: B.K. në emër të shpërblimit jubilar për 40 vite përvojë pune t'ia paguaj 150 % të vlerës së një page bazë dhe atë në shumën prej 875.95€.

II.DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve t'ia paguaj kamatën në lartësi prej 8%, nga data e ushtrimit të padisë datë 26.03.2021 deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 332.00€, e të gjitha në afat prej 7 ditësh nga marrjes së aktgjykimit.

### A r s y e t i m

Paditësit përmes të autorizuarës së tyre, pranë kësaj gjykate, me datë 26.03.2021, ka parashtruar padi kundër të paditurës, me objekt kontesti pagesën e pagave jubilarë. Në padi dhe në precizimin e datës 09.01.2024 ka paraqitur se paditësit janë të punësuar tek e paditura në SH.F.M.U. “...” në Prishtinë, si mësimdhënës, me kontratë pune në kohë të pacaktuar e lidhur ndërmjet paditëses dhe të paditurës. Ka theksuar se paditësve nuk i'u është bërë kompensimi për pagat jubilarë dhe atë: për paditësen e parë A.M.Sh. për 12 vite përvojë pune në vlerën 50% të pagës bazë t'ia paguaj shumën prej 210.62€, paditëses M.R. për 11 vite përvojë pune në vlerën e 50% të pagës bazë t'ia paguaj shumën prej 223.97€, paditëses V.R. për 13 vite përvojë pune në vlerën 50% të pagës bazë t'ia paguaj shumën prej 225.76€, paditëses D.H. për 18 vite përvojë pune në vlerën 50% të pagës bazë t'ia paguaj shumën prej 230.24€, dhe paditësit B.K. për 40 vite përvojë pune në vlerën e 150% të pagës bazë t'ia paguaj shumën prej 875.95€. Tutje ka theksuar se bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit, paditëses i takon e drejta për kompensim për shpërblim jubilar në bazë të nenit 35 par. 8 dhe nën par 8.1 të kësaj kontrate të nënshkruar mes Ministrisë së Arsimit dhe SBASHK-ut, me

kamatë ligjore 8% duke llogaritur nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive. Andaj ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet në tërësi kërkesëpadia si e bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura në përgjigjen në padi ka theksuar se e konteston në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, për arsye se një kompensim i tillë nuk është paraparë as me Ligjin e Punës nr.03/L-212. Po ashtu e paditura gjatë përgatitjes së buxhetit nuk ka paraparë në skemën e saj buxhetore, linje të veçantë buxhetore për këto lloje të kompensimeve. Prandaj, ka kërkuar nga gjykata pas administrimit të provave kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

Pasi që Gjukata bëri vlerësimin e provave të bashkangjitura padisë, si dhe pas pranimit të përgjigjes në padi, mbështetur në nenin 8 dhe 398 të LPK-së, ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, porse e paditura ka ngritur çështje që kanë të bëjnë me pamundësinë e përmbushjes së detyrimit. Në këtë rast kontestues është vlerësuar se nuk ka pengesa në kuptim të dhënies së vendimit meritor jashtë seance.

Nga provat e bashkangjitura padisë gjykata gjeti se paditëset janë në marrëdhënie pune tek e paditura, sipas kontratave të punës dhe atë: paditësja e parë A.M.Sh., sipas kontratës së punës të datës 01.09.2009, paditësja e dytë, M.R., sipas kontratës së punës të datës 01.09.2008, paditësja e tretë, V.R., sipas kontratës së punës të datës 19.10.2009, paditësja e katërt D.H. sipas kontratës së punës të datës 10.12.2001, dhe paditësit të pestë B.K. sipas kontratës së punës të datës 18.09.2018.

Faktin e lartësisë së pagës së paditëses, gjykata e vërtetoi përmes listës së pagave, ku përcaktohet se paga bazë e paditësve dhe atë: paditësja e parë A.M.Sh. ka pagën bazë 421.24€, paditësja e dytë, M.R. ka pagën bazë 447.94€, paditësja e tretë, V.R. ka pagën bazë 451.52€, paditësja e katërt D.H. ka pagën bazë 460.48€, dhe paditësit të pestë B.K. ka pagën bazë 581.86. Sipas nenit 329 par. 1 të LPK-së: Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të. Po ashtu bazuar në provat që kishin të bënin me vërtetimin e fakteve lidhur me ditët e prezencës në punë, si dhe përvojën e punës, gjykata i'u fali besimin e plotë, ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre.

Nga provat e administruara si më lartë, gjykata gjeti se paditëses së parë A.M.Sh. për 12 vite përvojë pune nuk i është paguar shpërblimi jubilar në vlerë të 50 % të një page bazë (paga 421.24€ x 50% = 210.62€), paditëses së dytë M.R. për 11 vite përvojë pune nuk i është paguar shpërblimi jubilar në vlerë të 50 % të një page bazë (paga 447.94€ x 50% = 223.97€), paditëses së tretë V.R. për 13 vite përvojë pune nuk i është paguar shpërblimi jubilar në vlerë të 50 % të një page bazë (paga 451.52€ x 50% = 225.76€), paditëses së katërt D.H. për 18 vite përvojë pune nuk i është paguar shpërblimi jubilar në vlerë të 50 % të një page bazë (paga 460.48€ x 50% = 230.24€), dhe paditësit të pestë B.K. për 40 vite përvojë pune nuk i është paguar shpërblimi jubilar në vlerë të 150 % të një page bazë (paga 581.86€ x 150% = 875.95€).

Këtë lloj kompensimi gjykata i'a njohu paditësve në harmoni me nenin 35 par.8, të KKAK-së: sipas të cilës punëtorët në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblim jubilar nga punëdhënësi i fundit : për 10 vite të përvojës së punës, në vlerë të 50 % të një page bazë, për 20 vite të përvojës së punës, në vlerë të 75 % të një page bazë, për 30 vite të përvojës së punës, në vlerë të një page bazë, për 40

vite të përvojës së punës, në vlerë të 150 % të një page bazë. Ndërsa, nga gjendja faktike e vërtetuar rezultoi se e paditura ka detyrimin e pagesës së pagave jubilarë, në vlerë të pagës bazë që kanë realizuar paditësit.

Gjykata duke ju referuar Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës dispozitat e së cilës aplikohen në tërë Republikën e Kosovës, ku në nenin 35 është paraparë e drejta punëtoreve të arsimit në shpërblim jubilar, gjeti se e njëjta është e aplikueshme nga hyrja në fuqi me datë 18.04.2017. Pas skadimit të kësaj kontrate, është nxjerrë kontrata e re, e cila i'u garanton punonjësve të arsimit këto të drejta.

Nga të lartcekurat gjykata ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit aprovues jashtë seance, në kuptim të nenit 398 i LPK-së, sipas të cilit “Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”. Duke qenë se ka lindur e drejta e paditësve për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtës për shpërblim jubilar, të njëjtit janë legjitimuar që të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga e paditura, së këndejmi, paditësit e kanë rolin e kreditorit kurse e paditura rolin e debitorit. Në kuptim të nenit 245 të Ligjit nr. 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve: “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”. Rrjedhimisht, duke qenë se e paditura i ka mbetur borxh paditësve, me aplikimin e dispozitës së lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësve t'ia kompensoj shumat si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata, pretendimet e të paditurës të ngritura përmes përgjigjes në padi se nuk kanë linjë buxhetore të ndarë për pagesën e pagave jubilarë i gjen si të pa bazuara dhe të pa mbështetura në asnjë normë ligjore të aplikueshme. Paditësit në rrugë gjyqësore ka filluar të realizoj një të drejtë ligjore që i garanton KKAK, kurse mungesa e buxhetit të të paditurës, nuk mund të ketë për efekt vendosjen ndryshe si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me lartësinë e kamatës së llogaritur prej 8%, gjykata vendosi në kuptim të nenit 382 të LMD-së, sipas të cilit Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë, e do të llogaritet nga dita e parashtrimit të padisë datë 26.03.2021.

Gjykata vendosi si në dispozitivin e II të këtij aktgjykimi, ashtu që e paditura të paguaj shpenzimet e procedurës në lartësi prej 332.00€, në kuptim të nenit 452 të LPK-së. Lartësia e shpenzimeve i referohet shpenzimeve për përpilimin e padisë në shumë prej 312.00€ - sipas tarifës së OAK dhe taksa gjyqësore në shumë prej 20.00€.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.1161/21, datë 19.01.2024

Gjyqtari  
Përparim Zeka

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së te njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.